

Ftesë për ofertë

Emri i vendit: Kosova

Emri i projektit: Projekti për Zhvillimin Institucional të Arsimit

Numri i huas: H3420

Titulli i ftesës për ofertë: Shkolla model e arsimit themelor (klasat 0-9)

Numri i ftesës për ofertë: KOS-IDEP/H3420/C3.3/WK-ICB/11-01

1. Kjo ftesë për ofertë pason njoftimin e përgjithshëm për prokurim për këtë Projekt që është publikuar në *Development Business*, botimi numër 742, më datën 16 janar 2009.
2. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka marrë një hua nga *Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar* për shpenzimet e *Projektit për Zhvillimin Institucional të Arsimit*, dhe synon që të shfrytëzojë një pjesë të huas për pagesat nën kontratën për ***Shkollën model të arsimit themelor (klasat 0-9)***, me numër ***KOS-IDEP/H3420/C3.3/WK-ICB/11-01***.
3. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë fton dorëzimin e ofertave të mbyllura nga ofertuesit e pranueshëm dhe të kualifikuar për ***Shkollën model të arsimit themelor (klasat 0-9)***.
4. Ofertimi do të kryhet sipas procedurave të ofertimit ndërkombëtar konkurrues të cilat parashkruhen në udhëzimet e Bankës Botërore: *Udhëzimet për prokurim në kuadër të huave të IBRD dhe kredive të IDA*, dhe janë të hapura për të gjithë ofertuesit nga shtetet burimore të pranueshme siç parashkruhet në Udhëzim.
5. Ofertuesit e pranueshëm dhe të interesuar mund të kërkojnë informata shtesë nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, nga: Luan Asllani, email: idep.lasllani@gmail.com, dhe duhet të dërgoni dokumentet e ofertimit në adresën e dhënë më poshtë nga ora 09:00 gjer në orën 16:00 sipas kohës së Kosovës.
6. Kërkesat për kualifikime përfshijnë:
 - **Historinë e kontratave të dështuara:** Dështimi i kontratës nuk ka ndodhur brenda tri (3) vitet e fundit para afatit për dorëzimin e aplikacionit, në bazë të të gjitha informatave rreth zgjidhjes së plotë të mosmarrëveshjeve apo procedurave gjyqësore. Mosmarrëveshje apo procedurë gjyqësore plotësisht e zgjidhur është mosmarrëveshja apo procedura e cila është zgjidhur në pajtim me mekanizmin për zgjidhje të mosmarrëveshjes sipas kontratës përkatëse, dhe ku janë shterë të gjitha instancat e ankesës në dispozicion të ofertuesit.
 - **Procedurat gjyqësore në pritje:** Të gjitha procedurat gjyqësore në pritje nuk paraqesin më shumë se njëzetepesë për qind (25%) të pasurisë neto të ofertuesit dhe trajtohen si të zgjidhura nga ana e ofertuesit

- **Performanca financiare e kaluar:** Dorëzimi i bilanceve të audituara, apo nëse nuk kërkohet me ligjin e shtetit të ofertuesit, deklaratat tjera financiare që janë të pranueshme për punëdhënësin, për tri (3) vitet e fundit për të demonstruar qëndrueshmërinë e tashme financiare të ofertuesve dhe rentabilitetin e mundshëm afatgjatë. Kërkesa minimale është që pasuria neto e ofertuesit, e kalkuluar si totali i aseteve minus përgjegjësitë totale, të jetë pozitiv.
- **Qarkullimi mesatar vjetor:** Qarkullimi mesatar vjetor prej 3 miliona euro, i kalkuluar si total i pagesave të certifikuara të pranuar për kontratat në vazhdim e sipër apo të kryera, brenda pesë (5) viteve të kaluara
- **Resurset financiare:** Ofertuesi duhet të demonstrojë qasje, apo disponueshmëri të resurseve financiare, siç janë asetet likuide, pasuria e paluajtshme e papenguar, linja të kredisë, dhe mjete tjera financiare, që nuk janë pagesë kontraktuale avans, për të plotësuar: (i) kërkesën për qarkullim të parasë së gatshme: 340,000.00 euro, (ii) kërkesat e gjithëmbarshme të qarkullimit të parasë për këtë kontratë dhe zotimet tjera pasuese.
- **Përvoja e përgjithshme:** Përvoja me kontrata në rolin e kontraktuesit, nënkontraktuesit apo kontraktuesit menaxhues për së paku pesë (5) vite para afatit të dorëzimit të aplikacionit, dhe me aktivitet në së paku nëntë (9) muaj në çdo vit.
- **Komentet specifike:** (a) Pjesëmarrja si kontraktues, kontraktues menaxhues apo nënkontraktues në së paku dy (2) kontrata brenda pesë (5) viteve të fundit, ku secila me vlerë prej së paku 1,6 miliona (euro), që janë kryer me sukses dhe në mënyrë substanciale dhe që janë të ngjashme me punët e propozuara. Ngjashmëria bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë apo karakteristikat tjera që përshkruhen në seksionin VI, kërkesat e punëdhënësit, b) për kontratat e sipërme apo kontratat tjera të ekzekutuara gjatë periudhës së parashkruar në 2.4.2 (a) më sipër, përvojë minimale në këto aktivitete kryesore: ndërtimi i shkollës, objekteve publike apo karakteristika të ngjashme sikurse subjekti i planifikuar i ndërtimit.

Margjina e preferencës për mallrat e caktuara të prodhuara brenda vendit **nuk** aplikohet. Hollësitë shtesë janë dhënë në dokumentin ofertues.

7. Pakoja e plotë e dokumenteve ofertuese në gjuhën angleze mund të blihet nga ofertuesit e interesuar në momentin e dorëzimit të aplikacionit të shkruar në adresën e poshtme dhe pas pagesës së taksës së pakthyeshme prej 50 euro. Metoda e pagesës do të bëhet me transferim bankar në:

Banka Qendrore e Kosovës

Numri i xhirollogarisë: 55.044.937

Xhirollogaria në: Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG

Am Stadtpark 9

1030 Wien

Austria

Swift Code: RZBAATWW

IBAN:AT26310000055044937

Bank Sort Code: 31000

Për përfituesin:

**Përfitues: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Xhironlogaria e përfituesit në BQK: 1000400070002605**

Dokumentet e ofertimit dërgohen përmes korrierit.

8. Ofertat duhet të dërgohen në adresën e poshtme para orës 14:00 (me kohën e Kosovës), më 9 mars 2012. Ofertimi elektronik *nuk* lejohet. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat hapen në prezencë të përfaqësuesve të ofertuesve që dëshirojnë të marrin pjesë personalisht apo *online* në adresën e poshtme në ora 14:15 (me kohën e Kosovës) më 9 mars 2012. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen nga *Sigurimi i ofertës* prej 40,000,00 euro apo në shumë ekuivalente në monedhën që konvertohet me lehtësi.

9. *Adresa për dorëzimin e ofertave të sipërpërmendura është:*

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT)

Për: Luan Asllani

Adresa: Rruga Agim Ramadani pn

Kati/numri i zyrës: Kati II, zyra numër 204

Qyteti: Prishtinë.

Kodi postar: 10000

Vendi: Kosova

Telefoni: 00 381 38 213 576

10. *Adresa për hapjen e ofertave të sipërpërmendura është:*

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT)

Për: Luan Asllani

Adresa: Rruga Agim Ramadani pn

Kati/numri i zyrës: Kati IV, zyra për prezantime.

Qyteti: Prishtinë.

Kodi postar: 10000

Vendi: Kosova